




**20
18**

Raport Vjetor



**Social
Contract
Institute**

Ky raport përfshin veprimtarinë e Institutit për Kontratën Shoqërore (SCI) nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2018. Ai është përgatitur nga stafi i SCI dhe është rishikuar dhe aprovuar nga Bordi i SCI.

Për pyetje dhe më shumë informacion mbi punën e SCI, ju lutemi na kontaktoni në:

SCI, Rr. "Reshit Çollaku", ndërtesa 24, hyrja 13, apt. 5
Tiranë, 1001, Shqipëri
Email: socialcontractinstitute@gmail.com
info@socialcontractinstitute.org

Celular: [+355 68 40 54 440](tel:+355684054440)

ose na ndiqni në:

www.socialcontractinstitute.org

<https://www.facebook.com/SCI-Social-Contract-Institute>

Përmbajtja

- 4 Mesazh nga Kryetari i Bordit**
- 5 Misioni dhe Vlerat**
- 6 Raporti i Aktiviteteve**
- 13 Zhvillimi Organizativ**
- 15 Financat**

Mesazh nga Kryetari i Bordit



Të dashur bashkëpunëtorë, përkras dhe miq të SCI,

Viti që lamë pas, ishte një vit i rëndësishëm për organizatën tonë.

Gjatë këtij viti Instituti për Kontratën Shoqërore hodhi hapa të sigurtë drejt formësimit të rolit të tij si një aktor aktiv i shoqërisë civile, zgjeroi gamën e nismave që ndërmori e realizoi, zgjeroi shtrirjen gjeografike të aktivitetit të tij, si dhe investoi intensivisht në forcimin e tij organizativ.

Në 2018, SCI ndërmori disa nisma të rëndësishme që kontribuan në zgjerimin e mundësive të qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje dhe në vendim-marrje në nivel të pushtetit vendor. Në këto përpjekje, SCI u përqendrua gjithnjë e më shumë në përkrahjen e atyre qytetarëve, të cilët mund të shërbejnë si aktorë të ndryshimit në komunitetet ku jetojnë, ndihmoi organet e pushtetit vendor të rrisin shkallën e transparencës në veprimtarinë e tyre, ju kushtoi vëmendje të veçantë nevojave dhe perspektivave të grave e vajzave dhe shfrytëzoi në mënyrë inovative mundësitë që ofron teknologjia e informacionit. Në kuadër të kontributit të tij për forcimin e sundimit të ligjit, Instituti bëri vlerësimin e dhënies së dënimeve alternative në disa rrethe gjyqësore, si një hap i parë për të investuar në rritjen e shkallës së

dhënies dhe të cilësisë së zbatimit të dënimeve alternative. Këtë vit SCI ndërmori edhe nismën e saj të parë rajonale. SCI, në bashkëpunim me katër organizata partnere nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, punoi me rreth 75 vajza nga këto pesë vende të Ballkanit Perëndimor në kuadër të nismës “Fuqia e Vajzave të Ballkanit”, duke përdorur artin e fotografisë si një mënyrë për t’i angazhuar vajzat në konceptimin e të ardhmes së rajonit në gjirin e Bashkimit Europian.

Këto aktivitete interesante dhe me vlerë e kjo rritje e punës së SCI u bënë të mundura falë punës së përkushtuar të stafit dhe ekspertëve të SCI, falë pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në nismat e SCI, por edhe falë bashkëpunimit me organizatave partnere e me institucioneve publike përgjegjëse për çështjet që adresojnë nismat e SCI, si dhe falë përkrahjes bujare të agjencive shqiptare dhe programeve ndërkombëtare që financuan punën e Institutit. Ndaj, në emër të SCI, i falenderoj nga zemra të gjithë këta bashkëpunëtorë e donatorë dhe ju ftoj të shfletoni këtë Raport Vjetor, një përmbledhje e punëve kryesore që SCI realizoi me sukses këtë vit.

Përshëndetje,
Andrea Lako

Misioni dhe Vlerat

SCI kontribuon në forcimin e praktikave dhe institucioneve demokratike nëpërmjet angazhimit qytetar, pjesëmarrjes në zhvillimin dhe zbatimin e politikave në nivel qendror dhe lokal, dhe promovimin e bashkëpunimit rajonal për një zhvillim të qëndrueshëm, bazuar tek drejtësia dhe mundësitë e barabarta.

SCI e përmbush këtë qëllim përmes hulumtimit, sondazheve, informacionit publik dhe arsimit, shkëmbimit të përvojave dhe informacionit, partneriteteve dhe rrjetëzimit, granteve, zhvillimit të kapaciteteve për institucione publike, private dhe jofitimprurëse, dhe avokim.

Për të arritur qëllimin, SCI zbaton metodologji që sigurojnë profesionalizëm dhe qëndrueshmëri dhe ndërmer programet dhe projekte në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Vlerat e SCI:

SCI në zhvillimin e veprimtarisë së saj beson dhe udhëhiqet nga disa vlera të përbashkëta të stafit dhe bordit të saj.

Ne:

- Besojmë tek misioni i organizatës;
- Promovojmë praktika, programe dhe politika progresive;
- Jemi të përkushtuar ndaj barazisë gjinore dhe përkrahjes sociale ;
- Respektojmë dhe vlerësojmë njerëzit e angazhuar në organizatë;
- Jemi profesionalë në punën tonë;
- Jemi të hapur ndaj larmishmërisë së ideve, qëndrimeve dhe bashkëpunësorëve të organizatës;
- Tregojmë vëmendje të veçantë për angazhimin e të rinjve, grave dhe vajzave;
- Trajtojmë njerëzit me drejtësi dhe dinjitet;
- Jemi solidarë me bashkëqytetarët dhe njerëzit në nevojë;
- Jemi kreativë në veprimtarinë e organizatës;
- Jemi bashkëpunës pa kërkuar protagonizëm;
- Promovojmë vullnetarizmin.

Programet kryesore të SCI janë:

- 1 **Angazhimi Qytetar**
- 2 **Zhvillimi dhe Zbatimi i Politikave në nivel Qendror dhe Lokal**
- 3 **Bashkëpunimi Rajonal**

Shteti i së Drejtës dhe Qeverisja e Mirë

Projekti

Rrjeti AIS, E-Demokracia (Për një Shoqëri aktive dhe gjithëpërfshirëse – Qytetaria Digjitale)

Konsortium

“Gruaja në Zhvillim”, Korçë organizata udhëheqëse; SCI dhe “Syri i Medias së Re”, Gjirokastrë, partnerë

Donator

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) - Programi CIVILISC, i financuar nga BE

Buxheti

25,910 Euro (për të tre partnerët) - 8,600 Euro për SCI

Kohëzgjatja

I shkurt – 30 korrik 2018

Në I shkurt 2018, SCI implementoi projektin “Rrjeti AIS, E-Demokracia (Për një Shoqëri aktive dhe gjithëpërfshirëse – Qytetaria Digjitale)”, në partneritet me dy organizata: “Gruaja në Zhvillim”, Korçë dhe “Syri i Medias së Re”, Gjirokastrë. Aktivitetet e projektit u zbatuan në 6 muaj në bashkinë e Devollit, Tepelenës dhe Libohovës. Qëllimi i projektit ishte përmirësimi i cilësisë së jetesës për qytetarët që jetojnë në bashkitë Devoll, Tepelenë dhe Libohovë, duke u dhënë atyre mundësinë për të marrë pjesë në procesin e hartimit të politikave dhe më saktësisht në çështjet që lidhen me ofrimin e shërbimeve nga zyrat dhe agjencitë e komunave përkatëse. SCI dhe partnerët e saj krijuan dy koalicione



lokale, një në Libohovë dhe një në Tepelenë, me pjesëmarrjen e anëtarëve aktivë të komunitetit. Këto koalicione, në bashkëpunim të ngushtë me Koalicionin Lokal të Devollit (që ishte krijuar tashmë nga një projekt i mëparshëm i zbatuar nga partneri lokal i SCI në Korçë). Stafi i projektit ka realizuar edhe dy Scorecards të bazuara në komunitet, në bashkinë e Tepelenës dhe Libohovës dhe ka monitoruar zbatimin e buxhetit të tri bashkive. Rezultatet u ndanë me publikun në dy forume të hapura që u zhvilluan në çdo bashki me pjesëmarrës nga institucionet e qeverisjes vendore, anëtarë të koalicionit lokal dhe qytetarë aktivë. Projekti gjithashtu paraqiti një iniciativë të re, “E-Demokracinë”, duke përdorur teknologjinë e informacionit për të ndërtuar një platformë interaktive online (www.e-demokracia.al) për t'i shërbyer qytetarëve të tri bashkive. Nëpërmjet kësaj platforme ata mund të paraqesin problemet, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me shërbimet e ofruara nga bashkitë. Anëtarët e Koalicionit Lokal sjellin shqetësimet e qytetarëve që raportohen përmes platformës tek zyrtarët e bashkisë dhe i ndjekin deri në fund për t'u siguruar që shqetësimet e qytetarëve adresohen. Pas përfundimit të projektit, anëtarët e Koalicionit Lokal morën përsipër administrimin e platformës, duke garantuar qëndrueshmërinë e saj.

Projekti

Për Bashki të Hapura dhe të Aksesueshme nga Qytetarët

Partner

Asnjë

Donator

ACTION SEE - financuar nga BE

Buxheti

6,843 Euro

Kohëzgjatja

1 prill – 31 gusht, 2018

Gjatë periudhës prill-gusht 2018, SCI zbatoi projektin “Për Bashki të Hapura dhe të Aksesueshme nga Qytetarët”, financuar nga ACTION SEE- Rrjeti i Përgjegjshmërisë, Teknologjisë dhe Hapësirës Institucionale në Evropën Juglindore, financuar nga Bashkimi Evropian. SCI zbatoi aktivitetet e projektit në bashkitë Fushë -Arrëz, Kurbin, Shijak, Rrogozhinë dhe Maliq. Projekti u përqendrua në bashki të cilat ende nuk kishin filluar të përgatitnin programin e tyre të transparencës dhe i erdhi në ndihmë në fillimin e këtij procesi.

Nga ky projekt u kryen analiza të regjistrave të kërkesave dhe ankesave në secilën bashki; kryen analiza të pozitës së Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në bashki dhe fushëveprimin e tij në secilën bashki; u organizua një fushatë sensibilizimi për qytetarët që jetojnë në këto bashki, duke i edukuar ata për të drejtën e tyre për qasje në informacion dhe shërbime komunale.



Pas përfundimit të projektit, dy bashki përfunduan dhe përditësuan programet e tyre të transparencës, tre bashki filluan të hartojnë Programin e tyre të Transparencës, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, në Shqipëri. Pesë bashkitë e synuara nga projekti, tani kanë regjistra të dedikuar për kërkesat / ankesat e qytetarëve; stafi i bashkive është më i vetëdijshëm për detyrimet ligjore që duhet t'i përgjigjen kërkesave të qytetarëve; secila bashki ka një fushë pune të përpunuar mirë për pozitën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në bashki; qytetarët, grupet e biznesit dhe aktorët e tjerë vendorë në secilën bashki kanë një kuptim më të mirë të të drejtave të tyre për qasje në informacion lidhur me bashkinë dhe mekanizmat që ata mund të përdorin për të kërkuar informacione dhe / ose shërbime.

Si pjesë e projektit, Drejtorja e SCI, Olda Ceta, mori pjesë në një vizitë studimore në Cardiff (Uells) dhe Edinburg (Skoci), organizuar për përfaqësuesit e organizatave që kishin zbatuar projekte të suksesshme në kuadër të programit ACTION SEE. Gjatë dy vizitave, pjesëmarrësit mësuan më shumë rreth modeleve për përfshirjen qytetare dhe proceset e demokracisë.

Projekti

Përmirësimi i Dhënies dhe Zbatimit të Dënimeve Alternative

Partner

Asnjë

Donator

Save the Children dhe CILSP me fonde të BE

Buxheti

23,800 Euro

Kohëzgjatja

1 prill, 2018 – 30 prill, 2019

Në 1 prill 2018, SCI filloi zbatimin e projektit “Përmirësimi i Dhënies dhe Zbatimit të Dënimeve Alternative”, një projekt njëvjeçar i financuar nga Monitorimi i Programit të Sub-Granteve të Sistemit Gjyqësor, zbatuar nga Save the Children dhe CILSP me fondet e BE. Përmes këtij projekti, SCI kontribuoi në: (i) përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat dhe monitoruar nga zyrat e Shërbimeve të Provës në Tropojë, Dibër, Kruja (në veri të Shqipërisë), dhe Përmet, Pogradec, Sarandë (në Shqipërinë Jugore) dhe më gjerë; dhe (ii) të krijojnë më shumë mundësi për shkelësit e ligjit për herë të parë dhe me rrezik të ulët që të respektohen të drejtat e tyre dhe të riintegrohen në shoqëri dhe të bëjnë një jetë larg krimit, pasi të përfundojnë dënimin e tyre. Për të zbatuar projektin, SCI angazhoi ekspertin e njohur, znj. Vjollca Meçaj,



dhe një ekip studentësh të diplomuar të Fakultetit Juridik, Universiteti i Tiranës. Ekipi i SCI: nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Shërbimet e Provës, me miratimin paraprak nga Ministria e Drejtësisë; ofroi trajnime për studentët e diplomuar në drejtësi që shërbyen si ekspertë të rinj për projektin; përgatiti Protokollin e Monitorimit për të vlerësuar vendimin e gjykatës që dënon me dënime alternative, dhe pyetësorin e intervistës për intervistat me gjyqtarët në gjykatat përkatëse; u takua me Kryegjyqtarët dhe Prokurorët në gjykatat përkatëse për të paraqitur qëllimin, qasjen dhe aktivitetet e projektit dhe siguruan bashkëpunimin e tyre; bëri kopje të vendimeve gjyqësore që detyrojnë shërbime alternative dhe i vlerësoi ato bazuar në Protokollin e Monitorimit; dhe filloi të organizojë grupe të përqendrimit me shkelësit që shërbyen për të nxjerrë në pah përvojën e shkelësve gjatë kryerjes së këtyre dënimeve, dhe për të marrë përshtypjet e tyre për mënyrat për të përmirësuar zbatimin e dënimeve.

Angazhimi Qytetar

Projekti

Përmirësimi i cilësisë së jetës së grave të varfëra dhe të papunësuar dhe kontributit të tyre në familje dhe në komunitet

Partner

Asnjë

Donator

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)

Buxheti

2,700,000 ALL

Kohëzgjatja

1 maj, 2017 – 31 janar, 2018

Në 31 janar 2018, SCI përfundoi projektin “Përmirësimi i cilësisë së jetës së grave të varfëra dhe të papunësuar dhe kontributit të tyre në familje dhe në komunitet”. Projekti u financua nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) dhe kontribuoi në: (i) pajisjen e grave dhe vajzave me njohuri dhe aftësi që u mundësojnë atyre të ushtrojnë të drejtat e tyre; dhe (ii) të përmirësojë qasjen në shërbimet shëndetësore dhe ndihmën juridike për gratë dhe vajzat në nevojë.

Stafi i projekti ka punuar me gratë dhe vajzat e varfra dhe të papunësuar, me institucione dhe me OSHC-të në shtatë



bashki të qarkut të Gjirokastrës. SCI: (i) prodhoi dy broshura edukative me informacione të dobishme mbi të drejtën ligjore të grave lidhur me martesën dhe informacionin kryesor mbi çështjet e shëndetit të grave; (ii) organizoi 17 workshop-e edukative për të drejtat ligjore dhe çështjet e shëndetit të grave me pjesëmarrjen e 146 grave dhe vajzave;

(iii) organizoi 2 seminare trajnuese me 36 zyrtarë lokalë që adresojnë shqetësimet e grave dhe vajzave të varfëra dhe të papunësuar në qarkun e Gjirokastrës; (iv) prodhoi 4 podkaste me informata të dobishme për të drejtën ligjore të grave lidhur me martesën dhe informacionet kyç për çështjet e shëndetit të grave; dhe (v) zhvilloi një tryezë të rrumbullakët mbi “Mbështetjen e Grave të Varfra dhe të Papunësuar” me pjesëmarrjen e anëtarëve të Parlamentit që përfaqësojnë qarkun e Gjirokastrës, zyrtarë nga shtatë bashki dhe OSHC-të nga rrethi. Si një vazhdim i projektit, SCI siguroi mbështetje për disa gra të varfra dhe të papunësuar që morën pjesë në aktivitetet e projektit dhe u ndihmuan të trajtonin shqetësimet specifike.

Projekti

Fuqia e Vajzave të Ballkanit

Partner

ArtPolis në Kosovë, Këshilli Rinor Kombëtar për Maqedoninë e Veriut (NYCM), IAct në Mal të Zi, dhe Organizata për Promovimin e Aktivizmit (OPA) në Serbi

Donator

Fondi i Ballkanit Perëndimor

Buxheti

12,000 Euro

Kohëzgjatja

1 maj, 2018 – 28 shkurt, 2019

Në maj 2018, SCI filloi zbatimin e projektit “Fuqia e Vajzave të Ballkanit” ku SCI është organizata udhëheqëse dhe 4 organizata të tjera nga rajoni i Ballkanit Perëndimor janë organizatat partnere. Ky projekt financohet nga Fondi i Ballkanit Perëndimor i cili është një fond i themeluar nga Ministritë e Punëve të Jashtme të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Objektivi kryesor i Fondit është rritja e bashkëpunimit midis vendeve anëtare, forcimit të marrëdhënieve dhe kohezionit rajonal, për të çuar përpara integrimin në Bashkimin Evropian. Projekti i SCI synon të ofrojë mundësi për vajzat nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Serbia dhe Mali i Zi që të njihen me njëra tjetren dhe të zhvillojnë përmes fotografisë, një vizion të përbashkët të shoqërive të



Ballkanit Perëndimor ku gratë dhe vajzat luajnë një rol po aq aktiv me burrat dhe djemtë në progres drejt integritit në BE. Gjatë vitit 2018, SCI dhe partnerët e saj: zgjodhën 15 - 20 vajza konkurente, nga 16 - 25 vjeç, në secilin vend që morën pjesë në aktivitetet e BGP; angazhuan artistë vendas dhe ekspertë që ofruan trajnime për vajzat pjesëmarrëse në secilin vend mbi fotografimin dhe përparimin e vendit të tyre në procesin e integritit në BE; si dhe mentoruan vajzat ndërsa filluan të bënin fotografi; u zhvilluan diskutime në grupin BGP në Facebook; u krijua platforma <https://bgp.socialcontractinstitute.org> ku vajzat postuan fotografite e tyre dhe publiku mund t'i vlerësojë; u arrit një marrëveshje me Qendrën për Hapje dhe Dialog (COD) në Tiranë në lidhje me Ekspozitën BGP që u mbajt në shkurt 2019. Projekti i BGP vazhdoi gjatë muajve të parë të 2019-ës.

Projekti

Qeverisja Komunitare: Sfidat e funksionimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve në qarkun e Korçës

Partner

Gruaja në Zhvillim, Korçë

Donator

LevizAlbania, me fonde nga Zyra Zvicerane e Bashkëpunimit

Buxheti

40,000 CHF

Kohëzgjatja

1 gusht, 2018 – 30 prill, 2019

Në gusht 2018, SCI filloi zbatimin e një projekti 9-mujor “Qeverisja Komunitare: Sfidat e funksionimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve në qarkun e Korçës” në bashkëpunim me partnerin tonë lokal Gruaja në Zhvillim në Korçë, mbështetur financiarisht nga LevizAlbania. Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore në qarkun e Korçës përmes funksionimit efektiv dhe inovativ të mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin e qeverisjes vendore në këtë rreth. Gjatë periudhës raportuese, SCI nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me

Këshillin e Qarkut të Korçës. Gjatë vitit 2018, SCI: nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Këshillin e Qarkut Korçë; bëri një vlerësim të progresit dhe boshllëqeve në zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në lidhje me mekanizmat për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin e qeverisjes vendore në rajonin e Korçës; themeloi një rrjet funksional të aktorëve lokalë që do të merrnin pjesë në mënyrë efektive në mekanizmat e qeverisjes komunitare në rrethin e Korçës; dhe filluan punën për krijimin e një platforme në internet për të shfaqur hartën e plotë të “agjentëve të ndryshimit” të pranishëm në çdo rajon në të gjashtë bashkitë e rrethit Korça. Agjentët e ndryshimit do të shërbejnë si pikë qendrore për komunitetet ku jetojnë në mënyrë që të adresojnë problemet, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me institucionet e qeverisjes vendore. Në anën tjetër, institucionet e qeverisjes vendore (falë Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar me Këshillin e Qarkut), mund të bashkëpunojnë me agjentët në mënyrë që të informojnë komunitetet për çështje të ndryshme.



Aktivitetet e tjera

Pjesëmarrja në Koalicionin “Drejtësi për Të Gjithë”

Gjatë vitit 2018, SCI kontribuoi në aktivitetet e Koalicionit “Drejtësi për Të Gjithë” në Shqipëri, një rrjet prej 32 OShC që kontribuon në një sistem drejtësie transparent, të pavarur dhe të përgjegjshëm, profesional dhe të besueshëm, duke u shërbyer qytetarëve, dhe veçanërisht, grupeve jofitimprurëse përmes monitorimit të drejtësisë, advokimit dhe institucioneve të arsimit publik. Këto aktivitete përfshijnë: monitorimin e krijimit të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë; monitorimi i procesit të vetingut; hartimi i strategjisë kombëtare të arsimit juridik publik në bashkëpunim me Parlamentin e Shqipërisë; fushata të ndryshme ndërgjegjësimi.

Udhëzues për Median mbi Integrimin Gjinor dhe Përfshirjen Sociale

Në Dhjetor 2018, SCI filloi punën për të zhvilluar një Udhëzues për Median në Integrimin Gjinor dhe Përfshirjen Sociale, për të përfshirë udhëzime praktike dhe burime në internet gazetarët mund të përdorin për të marrë të dhëna,



analiza dhe perspektiva që lidhen me diskriminimin me bazë gjinore në Shqipëri dhe më gjerë.

Mbledhja e fondeve për Darkën Gala të Strehës LGBTI

Gjatë muajve prill - maj 2018, SCI ishte pjesë e komitetit organizativ për Darkën e 4-të të Grumbullimit të Fondeve “Dashuria është GJITHECKA” në mbështetje të Strehës LGBTI. Ky event u zhvillua në 17 maj 2018, në Tiranë. Falë punës së madhe dhe mbështetjes së të gjithë njerëzve të angazhuar në organizimin e këtij event, SCI ndihmoi të mblidhen 35,000 dollarë jo vetëm duke siguruar performancën financiare të Strehës, por edhe në promovimin e punës së aktivistëve gjatë viteve, për kauzën LGBT.

Mbështetje për komunitetin Rom

Në Ditën e Aktivizmit – 22 Tetor 2018 - Stafit dhe vullnetarët e SCI vizituan Qendrën Komunitare në Shkozë që i shërben komunitetit Rom në Tiranë. Ata kaluan një ditë në këtë qendër duke ndihmuar në aktivitetet e saj të përditshme, shërbyen drekën për fëmijët, organizuan disa aktivitete në kohën e lirë të tyre dhe i ndihmuan me detyrat.



Zhvillimi Organizativ

Zhvillimi i Kapaciteteve


Që nga muaji shkurti 2018, SCI është pjesë e programit “Për zhvillimin e kapaciteteve”, të Projektit të përsheptuar të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit qytetar në Shqipëri (ACDC), financuar nga USAID / Shqipëri dhe zbatuar nga ANTTARC (Qendra Kombëtare e Trajnimit dhe Asistencës Teknike në Shqipëri). Programi synon të forcojë kapacitetet dhe llogaridhënien e organizatave të shoqërisë civile, organeve qeveritare dhe organizatave të sektorit privat për të nxitur dhe mbështetur proceset demokratike dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes, mbikëqyrjen e qytetarëve dhe luftën ndaj korrupsionit. Stafi i SCI ka ndjekur 10 seanca trajnimi për zhvillimin organizativ dhe një vizitë studimore në Varshavë të organizuar nga ACDC. Në tremujorin e fundit të 2018, ekspertët



e ACDC ndihmuan SCI për të hartuar Planin e parë Strategjik. Pjesëmarrja në këtë program ka ndihmuar SCI në krijimin e kontakteve, shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e partneriteteve me OSHC pjesëmarrëse që vijnë nga rajone të ndryshme në Shqipëri. Për shembull, SCI është në partneritet me dy OSHC të tjera pjesëmarrëse - AKS në Librazhd dhe GLV “Integrimi” në Dibër – në aplikimet e fundit për donatorë të ndryshëm.

Gjatë periudhës së raportimit, SCI vazhdoi të përfitonte nga mbështetja e East-West Management Institute (EWMI) me përpjekjet për zhvillimin organizativ dhe mbledhjen e fondeve të SCI, përmes Drejtorit të EWMI për Programet e Shoqërisë Civile, Delina Fico dhe zyrës së EWMI në New York.


Në Shtator 2018, SCI punësoi znj. Dea Miloti për pozicionin me kohë të plotë si Koordinatore e Projekteve. Dea ishte Koordinatore e Projektit për projektin BGP, menaxhon rrjetet sociale të SCI dhe ndihmon me detyra të tjera, sipas nevojës.



Impakti i SCI gjatë 2018

Financat

Buxheti për 2018
106,637 USD



- ▶ Angazhimi Qytetar
- ▶ Qeverisja e Mirë
- ▶ Aktivitete të tjera



Raport Vjetor 2018



Social
Contract
Institute